

Permbajtja

Hyrje	7
Kapitulli I: Shqyrtimi i Literaturës	8
1.1 Këmba diabetike.....	9
1.2 Çfarë është këmba diabetike?.....	9
1.3 Shkaqet e këmbës diabetike	9
1.3.1 Faktorët e jashtëm	10
1.4 Faktor Rreziku.....	100
1.5 Fiziopatologjia e këmbës diabetike	100
1.6 Ulcerat diabetike	100
1.7 Klasifikimi i këmbës diabetike.....	122
1.8 Diagnozat Infermierore	133
Risk per infeksion	143
Mungesë njohurish.....	144
Rrezik për dëmtimin e integritetit të lëkurës.....	14
Perfuzion joefektive i indeve.....	155
1.9 Kujdesi infermior në ulcerat diabetike.....	166
1.9.1 Menaxhimi I këmbës diabetike nga infermierët.....	166
1.9.2 Kujdesi infermior mbi këmbën diabetike.....	17
1.10 Niveli i njohurive e praktikave te infermierë ve në raport me menaxhimin e kembes diabetike.	18
1.11 Studime të realizuara mbi nivelin e njohurive e praktikave te infermierëve ne raport me menaxhimin e këmbës diabetike.....	19
Kapitulli II: Metodologjia	212
2.1 Qëllimi.....	222
2.2 Objektivat.....	Error! Bookmark not defined.
2.3 Hipoteza	222
2.4 Tipi i studimit.....	222
2.5 Përshkrimi i zonës së studimit.....	233
2.6 Popullata dhe Mostra.....	233
2.6.1 Karakteristikat e përgjithshme të popullatës	233
2.6.2 Kufijtë dhe madhësia e popullatës	233
2.6.3 Madhësia e mostrës	233
2.7 Përshkrimi i instrumentit matës	233
2.8 Përkufizimi i variableve të përfshirë në studim	234

2.9 Operacionalizmi i variableve	244
2.9.1 Metodatat.....	25
2.9.2 Burimet e studimit.....	25
2.10 Procesi i mbledhjes se te dhenave	26
2.11 Përshkrimi i instrumentit të mbledhjes së informacionit	26
Kapitulli III: Analiza e Rezultateve	27
3.1 Pjesa e parë: Të dhënat demografike të kampionit	27
3.2 Pjesa e dytë : Analiza e pyetësorit.....	33
Kapitulli IV: Diskutimet	512
4.1 Karakteristikat e infermierëve në lidhje me menaxhimin diabetik	512
4.2 Nivelet e njohurive të infermierëve të menaxhimit të këmbës diabetike.....	523
Kapitulli V: Konkluzione.....	534
Kapitulli VI: Rekomandime.....	545
REFERENCAT.....	556
Aneks	58
I – Akronime	58
II- Leja Etike	59
III- Pyetësori 1.....	Error! Bookmark not defined. 0

Deklaratë

Deklaroj se tema “Vlerësimi I njohurive dhe praktikave infermierore në menaxhimin e këmbës diabetike te infermierët e spitalit rajonal Vlorë”, është studimi im dhe cdo material të gjetur për temën e kam referuar në bibliografi.

Mirënjohje

Ky studim për mua ka qënë impenjativ, qysh nga hedhja e tij në letër deri në realizimin perfundimtar. Sigurisht që, me ndihmën e përkrahjen e miqve e familjarëve të mi gjithcka ka qënë më e lehtë.

Së pari falënderoj sot dhe gjithmonë familjen time, motrat e kunetrit e mi, që dhe pse se largu (Gjermani), më kanë dhënë gjithçka që unë kisha nevojë.

Falënderoj të gjithë stafin e Spitalit Rajonal të qytetit të Vlorës, që dhe pse per shkak te pandemisë së COVID-19, nuk kanë hezitur të më ndihmojnë.

Faleminderit stafit të Fakultetit të Shëndetit Publik, sepse falë tyre, sot une po mbyll studimet Post Universitare me rezultate exelente (9.3) dhe po marr në dorë një diplomë që kudo të shkoj në botë do me bëjë të ndihem dikushi!

Le të shpresojmë që pas disa vitesh kur të rihap këtë punim diplome, të kem arritur objektivat që synojë në profesionin tim!

Fatmira Karabollaj

Dedikim

Këtë studim ia dedikoj të gjithë infermierëve të Spitalit Rajonal Vlorë, që pavarësisht situatës së pandemisë për shkak të covid-19, vazhdojnë të jenë heronjtë tanë ditën, natën, në shi, në diell, kurdoherë...Jam krenare që jam një prej jush!

Abstrakti Shqip

Sfondi:Diabeti është një nga shkaktarët kryesorë të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë. Këmba diabetike është një ndër ndërlikimet që ka çuar në amputime të pallogaritshme dhe ulje të cilësisë së jetës të diabetikët. Ulçera diabetike në këmbë është një ndërlikim i parandalueshëm i diabetit nëse merremi me të në kohë. Infermierët, anëtarë të rëndësishëm të ekipit të trajtimit të diabetit, kanë një rol thelbësor në parandalimin e problemeve të këmbëve diabetike, në kujdesin dhe edukimin e pacientëve në rrezik për këmbën diabetike. Kështu, niveli i lartë i njohurive dhe praktikave infermiere do të sigurojnë gjithnjë kujdes më të mirë për pacientin.

Metodologjia:Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë njohuritë dhe praktikave e infermiereve në menaxhimin e këmbës diabetike në rrethin e Vlorës. Ky është një studim kros-seksional, i realizuar në Spitalin Rajonal Vlorë dhe Poliklinikë gjatë periudhës kohore Korrik-Shtator 2020. Si popullatë për studim janë përfshirë 100 infermier të përzgjedhur në mënyrë rastësore në katër pavione.Për këtë studim kam përdorur një pyetësor të vetë administruar. Përbëhej nga 2 pjesë, pjesa e parë përmban karakteristikat demografike që ka në përmbajtjen e saj një grup të dhënash përse i përket disa variablove universal si mosha, pavioni, vitet e punes etj. dhe pjesa e dytë përfshinte 15 pyetje të ndarë me 2 grupe pyetjesh që siguruan informacion mbi faktorët e riskut dhe parandalimin e këmbës diabetike. Të dhënat u përpunuan në paketën statistikore SPSS.

Rezultatet: Duke u bazuar në rezultatet e studimit mbi ndikimin e faktorëve demografik, rezultoi se arsimi, pavioni dhe eksperiencia në punë ndikojnë në nivelin e praktikave dhe njohurive mbi menaxhimin e këmbës diabetike (vlera $P < 0.05$). Ndërkohë 59% e infermiereve nuk trajnuan pacientë të rrezikuar nga ose me probleme diabetike në këmbë. Në studimin tonë, vetëm 15% e infermiereve ishin trajnuar në kujdesin për këmbët diabetike. Duke pranuar faktin se niveli i trajnimeve është i ulët, pjesëmarrja në trajnime të mëtejshme shihet si zgjidhja e problemit. Kështu të pyetur nëse kishin nevojë apo donin të merrnin trajnime të tjera, shumica e infermiereve me 78% u shprehën të interesuar.

Konkluzione:Në përgjithësi infermierët kanë njohuri të mira në menaxhimin e këmbës diabetike: në vlerësimin e njohurive mbi faktorët e riskut të këmbës, si dhe në parandalimin e këmbës diabetike, gjithsesi faktorë si pavioni, eksperiencia në punë dhe arsimi ndikojnë. Ata kanë mungesë të trajnimeve mbi menaxhimin e këmbës diabetike.78% e infermiereve të cilët u morën në studim, deklaruan faktin se kishin nevojë për trajnime, me qëllim zgjerimin e mëtejshëm të njohurive.

Rekomandime:Infermierët duhet të marrin pjesë në mënyrë të vazhdueshme në trajnime në mënyrë që njohuritë që ata zotërojnë në lidhje me menaxhimin e këmbës diabetike jo vetëm të përmirësohen, por edhe të zhvillohen.Infermierët kanë nevojë të mësojnë teknika të reja të cilat janë efikase në menaxhimin e këmbës diabetike. Gjithashtu kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme, për të zhvilluar njohuritë e praktikave të tyre. Këshillimi i tyre nga profesionistë parandalon raste të gabimeve. Infermierët duhet të kujdesen edhe për edukimin e pacientëve të tyre duke e parë si një element kyç në përmirësimin e gjendjes shëndetsore. Në Shqipëri duhet të realizohen më tepër studime në lidhje me këtë fushë.

Fjalë kyçe: *ulcer diabetike, faktorë risku, menaxhimi i këmbës diabetike, niveli i njohurive.*

Abstract

Background: Diabetes is one of the leading causes of mortality and morbidity. Diabetic foot is one of the complications that has led to incalculable amputations and reduced quality of life in diabetics. Diabetic foot ulcer is a preventable complication of diabetes if we deal with it in time. Nurses, important members of the diabetes treatment team, have an essential role in preventing diabetic foot problems, in caring for and educating patients at risk for diabetic foot. Thus, the high level of knowledge and nursing practices will always provide better care for the patient.

Methodology: The purpose of this study is to assess the knowledge and practices of nurses in the management of diabetic foot in the district of Vlora. This is a cross-sectional study, conducted at the Vlora Regional Hospital and Polyclinic during the period July-September 2020. As a population for the study 100 randomly selected nurses were included in four wards. For this study I used a self-administered questionnaire. It consisted of 2 parts, the first part contains the demographic characteristics that a set of data has in its content in terms of some universal variables such as age, ward, years of work, etc. and the second part included 15 separate questions with 2 sets of questions that provided information on risk factors and prevention of diabetic foot. The questionnaire contained simple questions and did not require information that could put the nurse in difficulty while completing it. It was chosen to be applied in the afternoon shifts, as the most suitable moment for the nurses. Data were processed in SPSS statistical package.

Results:Based on the results of the study on the impact of demographic factors, it turned out that education, ward and work experience affect the level of practices and knowledge on diabetic foot management (value $P < 0.05$). Meanwhile 59% of nurses did not train patients at risk of or with diabetic foot problems. In our study, only 15% of nurses were trained in diabetic foot care. Acknowledging the fact that the level of training is low, participation in further training is seen as the solution to the problem. Thus asked if they needed or wanted to receive further training, the majority of nurses with 78% expressed interest

Conclusions:In general, nurses have good knowledge in the management of diabetic foot: in assessing the knowledge on risk factors of the foot, as well as in the prevention of diabetic foot, however factors such as ward, work experience and education influence. They lack training on diabetic foot management. 78% of the nurses who were surveyed stated that they needed training in order to further expand their knowledge

Keywords: diabetic ulcer, risk factors, diabetic foot management, level of knowledge

Diabeti mund të dëmtojë nervat e arterieve në këmbë. Këmba diabetike është një ndërlikim serioz i diabetit me vdekshmëri të lartë, sëmundshmëri dhe kosto të trajtimit, e cila mund të parandalohet nga edukimi i pacientit dhe diagnostikimi i hershëm.

Dëmtimi ulceroz i këmbës diabetike është një ulceracion që mund të formohet në pjesën e këmbës dhe kavilies tek personat e prekur nga diabeti i tipit 1 dhe 2. Bazuar në studime të ndryshme më shumë se 25% e personave diabetikë zhvillojnë gjatë jetës probleme me këmbët. Më shumë se 80% e amputimeve në botën lindore kryhen tek personat ku lezioni ulceroz është faktori kryesor. Është vërtetuar shkencërisht se trajtimi i këmbës diabetike sjell rezultate më të mira klinike.

Ky trajtim nis që nga niveli i njohurive të infermiereve mbi menaxhimin e këmbës diabetike der te kujdesi infermieror të këta pacient.

Ky kujdes infermieror në menaxhimin e këmbës diabetike kërkon të testojë njohuritë e praktikave të infermiereve të spitalit rajonal Vlorë dhe si rrjedhojë të ofrojë informacion për infermierët në mënyrë që ti ndihmojë ata në diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve me këmbë diabetike.

Vlen të theksohet fakti që ky është studimi i parë i bërë mbi menaxhimin e këmbës diabetike në rrethin e Vlorës dhe uroj që të ketë sado pak ndikim në studime të tjera.

Kujdesi infermieror në menaxhimin e këmbës diabetike u siguron infermiereve dhe ofruesve të tjerë të kujdesit shëndetësor një burim gjithëpërfshirës dhe praktik që u lejon atyre të bashkëpunojnë dhe të këshillojnë më efektivisht, si dhe të edukojnë pacientët në menaxhimin e këmbës diabetike.

Kapitulli I: Shqyrtimi i Literaturës

1.1 Këmba diabetike

OBSH: 15% e diabetikëve do të ballafaqohen në jetën e tyre me një ulcer të këmbës që kërkon trajtim mjekësor.

Pas shumë vitesh progresi në trajtimin e diabetit, sot mund të pranojmë me lehtësi që problematika kryesore e kësaj sëmundjeje nuk qëndron më tek mbijetesa [5].

Mjekësia dhe teknologjia kanë avancuar edhe pse Namëong zbuloi se mjekët, infermierët dhe trainerët kanë njohuri të pamjaftueshme për kujdesin diabetik të këmbëve [6].

Ndër ndërlikimet më shqetësuese të diabetit është dhe e ashtuquajtura “këmba diabetike”. Ky është komplikacioni që sjell numrin më të madh të diabetikëve të shtruar në spital dhe për të cilët, shpenzimet janë të konsiderueshme. Nëse ne mendojmë për parashikimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë që ka parashikuar një shifër tek 250 milionë diabetikë në 2025 krahasuar me 120 milionë të vlerësuar në 1996, duhet të rimendojmë për dimensionin që do të marrë ky problem. Vlerësime, gjithnjë të OBSH-së, thonë që në fakt 15% e diabetikëve do të ballafaqohen në jetën e tyre me një ulcera të këmbës që kërkon trajtim mjekësor [7].

Këmba diabetike është një ndërlikim serioz i diabetit me vdekshmëri të lartë, sëmundshmëri dhe kosto të trajtimit, e cila mund të parandalohet nga edukimi i pacientit dhe diagnostikimi i hershëm [1–4]. Problemet e këmbëve diabetike janë një shkak i shpeshtë i pranimeve në spital për pacientët me diabet dhe përbëjnë faktorin kryesor që përcakton cilësinë e jetës së pacientëve diabetikë [8,9]. Problemet e këmbëve diabetike jo vetëm që shkaktojnë humbjen e punës / të ardhurave nga pacienti, pengojnë ndjekjet e tyre arsimore dhe dëmtojnë marrëdhëniet shoqërore, por gjithashtu shkaktojnë dëmtim psikologjikisht të pacientëve dhe indirekt mjedisëve të tyre.

1.2 Çfarë është këmba diabetike?

Flitet për këmbë diabetike kur neuropatia diabetike dhe/ ose arteriopatia e gjymtyrëve të poshtme ndërhyjnë në funksionin ose në strukturën e këmbës. Të dyja rastet të njohura gjithashtu si këmba neuropatike apo këmba ishemike, janë shumë të ndryshme midis tyre, por në pjesën më të madhe, veçanërisht në moshën e avancuar, bashkëjetojnë, domethënë flitet kështu për këmbën neuroishemike [10].

1.3 Shkaqet e këmbës diabetike

Dëmtimet në këmbë mund të shkaktohen mbi bazën e një artriti obliterans, mbi bazën e neuropatisë diabetike ose pranisë të të dyjave së bashku.

- ✓ Faktorët metabolikë, të tilla si glukozja e lartë në gjak, kohëzgjatja e diabetit, nivelet jonormale të yndyrnës në gjak dhe nivele të ulëta të insulinës.
- ✓ Faktorët neurovaskular, duke cuar në dëmtimin e enëve të gjakut që mbartin oksigjenin dhe lëndët ushqyese të nervave.
- ✓ Faktorët që shkaktojnë inflamacion autoimun në nerva.
- ✓ Lëndime mekanike të nervave, të tilla si sindromi i tunelit të kycit të dorës.
- ✓ Tipare të trashëguara që rrisin ndjeshmërinë ndaj sëmundjeve nervore.
- ✓ Faktorët e jetesës, të tilla si pirja e duhanit apo përdorimi i alkolit.
- ✓

1.3.1 Faktorët e jashtëm

- ✓ Këpucët e shtrënguara ose me palosje.
- ✓ Guriçka ose materiale të forta në këpucë.
- ✓ Çorape të shtrënguara, sidomos Ilastiku që pengon qarkullimin e gjakut.
- ✓ Ecje pa çorape, pa shapka qoftë dhe brenda në shtëpi [10].

1.4 Faktor Rreziku

Faktorët e rrezikut duhet të njihen dhe monitorohen për të parandaluar ndërlikimet diabetike në këmbë. Faktorët më të rëndësishëm të rrezikut për ulçerimin e këmbës përfshijnë neuropatinë periferike, sëmundjen vaskulare periferike, deformimin e këmbës, ulçerimin e mëparshëm të këmbës dhe amputimin [11-12]. Përveç kësaj, gërvishtjet kronike të përsëritura, gërvishtjet e vogla, acarime të ndryshme, kallot, prerja e pahijshme e thonjve të këmbëve, infeksioni i kërpudhave, higjiena e dobët e këmbëve, përdorimi i papërshtatshëm i këpucëve dhe kontrolli i keq metabolik, janë shkaqet më të zakonshme të formimit të ulçerës së këmbës tek pacientët [11,13,14]. Për shkak të këtyre ndryshimeve, këmbët traumatizohen më lehtë dhe plagët shërohen ngadalë, gjë që rrit rrezikun e infeksionit. Për të kontrolluar këta faktorë rreziku, të gjithë pacientët me diabet duhet të ekzaminohen të paktën një herë në vit për problemet e mundshme të këmbëve dhe ata me faktor rreziku duhet të ekzaminohen çdo 3-6 muaj [3, 4].

1.5 Fiziopatologjia e këmbës diabetike

Në pacientët me DM ka një dukuri të rritur të rrezikut kryesor të shfaqjes dhe zhvillimit të ulçerave në këmbë, si dhe përkatësisht neuropatia periferike, sëmundja vaskulare dhe prishja e përgjigjes ndaj infeksionit. Përveç kësaj, në DM ekziston një çrregullim i shërimit të plagëve që rrit rrezikun e infektimit [15,16]. Neuropatia në DM manifestohet kundër motorit, sensorit dhe autonomit. Dëmtimi të inervimi i muskujve të këmbës shkakton një çekuilibër midis përkuljes dhe zgjatjes së këmbës, duke rezultuar në deformim dhe ndryshim të pikave të presionit. Gradualisht, kjo do të shkaktojë dëmtim të lëkurës që zhvillohet në ulcera. Në arteriet periferike, hiperglicemia shkakton endoteliale mosfunksionimi në muskujt e enëve të gjakut, si dhe zvogëlon prodhimin e vazodilatatorit nga endoteli duke rezultuar në shtrëngim. Hiperglicemia në DM rritet me tromboksani A2, përkatësisht vazokonstriktori dhe agregatët e trombociteve, duke rezultuar në rritje të plazmës. Hipertensioni dhe dislipidemia gjithashtu kontribuojnë në shfaqjen e sëmundjes arteriale periferike.

Shpjegimi i mësipërm do të çojë në arterial okluziv, sëmundje e cila më pas shkakton iskemi të pjesës së poshtme të ekstremitetave dhe rrit rrezikun e ulçerave. Ulcerat do të infektohen lehtësisht, do të zhvillohen në gangrenë dhe do të përfundojnë me një amputim të këmbës së poshtme [16].

1.6 Ulcerat diabetike

Ka rëndësi të dallojmë sipas shkakut tre lloje ulçerash:

a. *Ulçera neuropatike*

Si shkak fillestar është një lezjon i vogël i lëkurës, pasojë e uljes së sensitivitetit ose ekzistenca e pikave të presionit anormal (neuroarthropati). Zakonisht manifestohet në gishtin e madh të këmbës, në thëmbër, në planta pedis dhe në kokat e metatarsëve. Neuropatia është shkak i mungesës së dhembjes në ulçerë.

Në rastin e ulçerës neuropatike eliminohen indet nekrotike dhe kallozitetet. Karakteristikë është formimi I fibrinës.



Figura 1: Ulcera neuropatike

b. Ulçera ishemike

Kjo është pasojë e një insuficence vaskulare dhe uljes së furnizimit me oksigjen dhe substancë ushqyese , çka provokon ishemi të ekstremitetit, nekroz dhe gangrenë të lokalizuar. Kjo ndodh në macroangiopati/atherosclerozë (dëmtim i vazave të mëdha); ose në formën e mediosklerozës në nivelin e tunica media të arterieve; microangiopati (dëmtim I vazave të vogla).

Indi ishemik përbën një terren të përshtatshëm për zhvillimin e bakterieve dhe zhvillimin e një infeksioni të rëndë.

Në rastin e ulçerës ishemike nuk duhet ta hapim, sidomos në kushte shtëpie, por duhet ta mbajmë plagën të thatë.



Figura 2:

Ulcera ishemike

c. Ulçera neuroishemike

Është një formë mikse e ulçerës neuropatike dhe ishemike që provokohet nga neuropatia periferike dhe insuficiensa vaskulare periferike. Dëmtimi ndodh në lëkurë në pjesët interne dhe ekterne të këmbës. Ulcera neuroishemike është një ndër komplikacionet më të rënda të këmbës diabetike [16].



Figura 3: Ulcera neuroishemike

1.7 Klasifikimi i këmbës diabetike

Ne literaturë sisteme të ndryshme klasifikimesh egzistojnë, dhe raportohen, por klasifikimi I zhvilluar nga Wanger [17] është pranuar gjerësisht dhe përdoret në vende të ndryshme. Kohët e fundit në universitetin e Texasit [18], një grup studiuesish kanë zhvilluar një alternativë tjetër klasifikimi më të detajuar se ajo e Wanger ku kanë përfshirë prezencën e infeksionve dhe isheminë. Krahasimi I të dy sistemeve të klasifikimit të plagëve ka konkluduar se skema e universitetit të Teksasit është më I mirë dhe më parashikues se sistemi I vjetër [19].

Grada	Përshkrimi
0	Pa plagë, por faktorë predispozues (PSH deformim,kallus,humbje të ndjeshmëris)
1	Plagë superficiale
2	Plagë e thellë, prekje të indeve si tendinat apo muskujt pa prekje të kockave
3	Plagë e thellë, prekje e kockes ostiomelit
4	Gangrenë parciale
5	Gangrenë e gjithë këmbës

Figura 4:Klasifikimi I Wagner

faza	Shkalla 0	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3
------	-----------	-----------	-----------	-----------

A	Lezion preulceros ose post ulceroz	Plagë superficiale	Plagë e thellë prekje e tendinave ose muskujve	Plagë të thella dhe prekje e kockës
	Pa prishje të tërësisë së lëkurës			
B	+infeksion	+infeksion	+infeksion	+infeksion
C	+ishemi	+ishemi	+Ishemi	+ishemi
D	+infeksion dhe ishemi	-//-	-//-	-//-

Figura 5:Klasifikimi I Universitetit te Texasit

Grada 0	Nuk ka lezjone të hapura, por prezencë të një deformimi ose hyperkeratozë
Grada 1	Ulcerë superficiale pa penetrim në indet e thella
Grada 2	Përhapje e thellë drejt tendineve ose kockave dhe artikulacioneve
Grada 3	Tendinit, osteomielit, abces ose celulit profund
Grada 4	Gangrenë e një gishti ose të pjesës fundit të këmbës shpesh e shoqëruar me infeksion plantar
Grada 5	Gangrenë masive e këmbës shoqëruar me lezjone nekrotike dhenjë infeksion të indeve të buta.

Figura 6: Gradat e keqësimit të këmbës diabetike sipas Wagner

1.8 Diagnozatat Infermierore

- **Rrezik për nivelin e paqëndrueshëm të glukozës në gjak**

Hiperglicemia ose nivelet e larta të glukozës në gjak mund të ndodhin në një sërë situatash klinike. Diabeti mellitus është çrregullimi më i zakonshëm që shoqërohet me nivele të ngritura të glukozës në gjak.

Hipoglicemia ndodh më shpesh si rezultat i administrimit të tepërt të insulinës tek personi me diabet mellitus. Këtu janë disa faktorë që mund të lidhen me rrezikun për nivelin e paqëndrueshëm të glukozës në gjak: Njohuri të mangëta të menaxhimit të diabetit, niveli i zhvillimit, mosbalancimi i aktivitetit, monitorimi joadekuat i glukozës në gjak, mungesa e insulinës dhe teprica e insulinës.

- *Ndërhyrjet infermierore*
- ✓ Ndihmoni pacientin në identifikimin e modeleve të të ngrënit që duhet të modifikohen.
- ✓ Administroni insulinë bazale dhe prandiale.
- ✓ Referojuni një dietologu të regjistruar për udhëzime të dietës individuale.

- ✓ Administroni ilaçe të insulinës sipas udhëzimeve.
- ✓ Raportoni PB për më shumë se 160 mm Hg (sistolik). Administroni hipertensionin siç përshkruhet.
- ✓ Siguroni ushqim ose burime të tjera të glukozës siç drejtohet për hipogliceminë.
- ✓ Edukoni pacientin për rëndësinë e ndjekjes së një plani të përcaktuar të vaktit.
- ✓ Edukoni pacientin për mënyrat e duhura të marrjes së ilaçeve të përshkruara.
- ✓ Instruktoni pacientin që përjeton hipoglikemi në lidhje me veprimet e duhura për të rritur glukozën në gjak.
- ✓ Diskutoni për rëndësinë e ushtrimeve ekuilibër me marrjen e ushqimit.

Risk per infeksion

Prania e DM shpesh është risk për infeksione pasi vet organizmi i njeriut nuk është në gjendjet më të mirë të mundshme. Kjo ndodh për faktorë risku të ndryshëm si: mbrojtje joadekuate primare, njohuri të pamjaftueshme për të shmangur ekspozimin ndaj patogjenëve, mbrojtjet e kompromentuara të strehuesit, qarkullimi i kompromentuar, kontaktoni me agjentë ngjitës, rritja e ndjeshmërisë së foshnjës, mungesa e imunizimit, partnerë të shumëfishtë seksi dhe sëmundje kronike.

- *Ndërhyrjet infermierore*
- ✓ Mbani ose mësoni pacientin për ndryshimet e veshjes dhe kujdesin për plagën, menaxhimin venoz IV periferik dhe qendror, dhe kujdesin apo trajtimin e kateterit.
- ✓ Mësoni pacientin të laj duart para dhe pas kontaktit me të tjerët.
- ✓ Inkurajoni marrjen e ushqimeve të pasura me proteina dhe kalori.
- ✓ Inkurajoni marrjen e lëngjeve nga 2,000 deri në 3,000 mL ujë në ditë, përveç nëse kundëriindikohet.
- ✓ Inkurajoni kollitjen dhe ushtrimet e frymëmarrjes së thellë; ndryshime të shpeshta të pozicionit.
- ✓ Rekomandoni përdorimin e furçave të dhëmbëve me furça të buta dhe zbutësve të jashtëqitjes për të mbrojtur mukozat.
- ✓ Kufizoni vizitorët [20].

Mungesë njohurish

Kjo diagnozë lidhet me: gjendjen e re, kompleksitetin e trajtimit, mungesën e ekspozimit, kufizimin njohës/fizik, mungesën e interesit për të mësuar, interpretimin e gabuar të informacionit, motivin e zvogëluar për të mësuar, gjendjen emocionale që ndikon në të mësuar (ankthi, mohimi ose depresioni), mosnjohjen e burimeve të informacionit dhe mungesën e kujtesës.

- *Ndërhyrjet infermierore*
- ✓ Jepni komoditet fizik për pacientin.
- ✓ Përfshini pacientin në krijimin e planit mësimor, duke filluar me vendosjen e objektivave dhe qëllimeve
- ✓ Përfshini pacientin në shkrimin e rezultateve specifike për sesionin mësimor, siç është identifikimi i asaj që është më e rëndësishme për të mësuar nga këndvështrimi dhe mënyra e jetesës së tyre.
- ✓ Eksploroni reagimet dhe ndjenjat në lidhje me ndryshimet.

- ✓ Mbështetni të mësuarit vetë-drejtuar, vetë-projektuar. .
- ✓ Ndhmoni pacientin në integrimin e informacionit në jetën e përditshme.
- ✓ Jepni shpjegime dhe demonstrata të qarta, të plota dhe të kuptueshme.
- ✓ Jepni informacion mbi përdorimin e mediave.

Rrezik për dëmtimin e integritetit të lëkurës

Rreziku për dëmtimin e lëkurës vjen nga: irrituesit kimikë të lëkurës (p.sh., ngjyrat e flokëve, sapunët), dermatiti, kruarja (p.sh., lëkura e thatë, reaksionet alergjike), edemë, inkontinencë fekale ose urinare, hipertermia ose hipotermia, gjendje ushqyese e paekuilibruar, palëvizshmëri, deficit i imunologjik, qarkullimi i dëmtuar, përdorimi afatgjatë i steroideve, faktorët mekanikë (p.sh., presioni, prerja, fërkimi).

- *Ndërhyrjet infermierore*
- ✓ Inkurajoni pacientin të ndryshojë pozicion çdo 15 minuta.
- ✓ Inkurajoni zbatimin e pajisjeve lehtësuese.
- ✓ Për pacientët me rrezik të moderuar: dyshek me ujë, dyshek me ajër statik ose dinamik
- ✓ Shtretërit me humbje të ulët të ajrit lejojnë ngritjen e krevatit dhe transferimin e pacientit.
- ✓ Inkurajoni zbatimin e një orari kthyes, duke kufizuar kohën në një pozicion në 2 orë ose më pak, nëse pacienti është i kufizuar në shtrat.
- ✓ Inkurajoni ushqimin dhe hidratimin adekuat
- ✓ Marrja e lëngjeve prej 2000 ml / ditë përveç nëse është e kufizuar nga ana mjekësore.
- ✓ Hidratimi dhe ushqyerja e mjaftueshme ndihmojnë në ruajtjen e turgorit. Lëkurë të pastër, të thatë dhe të lagur dhe shmangni ujin e nxehtë.

Perfuzion joefektive i indeve

Në këtë diagnozë ndikojnë: afiniteti i ndryshuar i hemoglobinës për oksigjenin, ulja e përqendrimit të hemoglobinës në gjak, helmimi nga enzimët, problemet e shkëmbimit, hipervolemia, hipoventilimi, hipovolemia, transporti i dëmtuar i oksigjenit nëpër membranën alveolare dhe / ose kapilare, ndërprerja e rrjedhës arteriale, ndërprerja e rrjedhës venoze, reduktimi mekanik i rrjedhjes venoze dhe / ose arteriale të gjakut, mospërputhja e ventilimit me rrjedhën e gjakut

- *Ndërhyrjet infermierore*
- ✓ Kontrolloni për ekuilibrin optimal të lëngjeve. Administroni lëngje IV siç është porositur. Marrja e mjaftueshme e lëngjeve mban presione adekuate të mbushjes dhe optimizon prodhimin kardial të nevojshëm për perfuzionin e indeve.
- ✓ Vini re prodhimin e urinës. Ulja e perfuzionit renal mund të ndodhë për shkak të okluzionit të enëve të gjakut.
- ✓ Ruani prodhimin kardial optimal. Kjo siguron perfuzion adekuat të organeve vitale.
- ✓ Merrni parasysh nevojën për embolektomi të mundshme, heparinizim, terapi vazodilatatore, terapi trombolitike dhe shpëtim të lëngjeve [20].

1.9 Kujdesi infermieror në ulcerat diabetike

1.9.1 Menaxhimi i këmbës diabetike nga infermierët

Këmba diabetike ka nevojë për një qasje të ekipit multidisiplinar sepse kërkon trajtim afatgjatë duke përdorur shumë fusha të ekspertizës [21, 22, 23]. Puna multidisiplinare e ekipit mund të zvogëlojë ulçerën e këmbës dhe normat e amputimit, të ulë kostot e kujdesit shëndetësor dhe të çojë në cilësi më të mirë të jetës për pacientët me rrezik të ulçerës diabetike të këmbës [24, 25]. Anëtarët e ekipit të kujdesit për këmbët diabetike zakonisht përbëhen nga një mjek i përgjithshëm, infermier, edukator, ortotist, podiatër, kirurg vaskular, specialist i sëmundjes së infeksionit, dermatolog, endokrinolog, dietolog dhe kirurg ortopedik [23, 26, 27]. Megjithëse të gjithë anëtarët e ekipit duhet të edukojnë pacientin, infermierja dhe podiatri shpesh janë burimet kryesore të informacionit për pacientin [25].

Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit të duhur për kujdesin e rregullt të këmbëve luajnë një rol kontribues në shkaktimin e problemeve të këmbëve [28–30]. Një kurs specifik edukimi për kujdesin për këmbët dhe plagët zvogëlon shkallën e ulçerave të këmbëve dhe amputimeve, dhe udhëzimet ekzistuese tregojnë nevojën për edukimin e pacientëve si një parakusht për të parandaluar ulcera [31, 32]. Në fakt, edukimi i pacientëve në vetëmenaxhimin e këmbës konsiderohet gurthemeli për të parandaluar ulcerat diabetike të këmbëve. Qëllimet e trajnimit janë të motivojnë pacientin dhe të krijojnë aftësi adekuate për të maksimizuar përdorimin e metodave parandaluese [13]. Sidoqoftë, infermierët janë pika kryesore e kontaktit për pacientët dhe shihen si një burim informacioni nga pacientët. Në mënyrë që infermierët të përmbushin këtë rol, ata duhet të kenë njohuri në lidhje me menaxhimin e kujdesit diabetik të këmbëve dhe t'ia përcjellin këtë njohuri pacientit [33–35].

Për të kontrolluar këta faktorë rreziku, të gjithë pacientët me diabet duhet të ekzaminohen të paktën një herë në vit për problemet e mundshme të këmbëve, dhe ata me faktor rreziku (të) duhet të ekzaminohen çdo 3-6 muaj [3, 4]. Diagnostifikimi i këmbës në rrezik, ekzaminimi i rregullt i këmbës në rrezik, edukimi i pacientëve, familjes dhe punonjësve shëndetësorë, menaxhimi i patologjive joulcerative dhe administrimi i ulçerës diabetike janë elementet kryesore të menaxhimit të këmbës diabetike [20]. Për më tepër, faktorë të tjerë të rrezikut si hipertensioni, alkooli, pirja e duhanit, hiperlipidemia, mbipeshja dhe dëmtimi i shikimit duhet të adresohen te pacientët [36,37].

Kontrolli dhe vlerësimi i këmbës për të identifikuar këmbën me rrezik të lartë kanë për qëllim parandalimin e komplikimeve serioze të ulçerimit dhe amputimit. Ndjenjat mbrojtëse ndijore, struktura e këmbës dhe biomekanika, struktura vaskulare dhe integriteti i lëkurës duhet të vlerësohen gjatë ekzaminimeve të këmbëve diabetike [26]. Kur ekzaminohet këmba në rrezik, vazat (çalimi, dhimbja në qetësi dhe palpimi i pulsit të këmbës), lëkura (kallot, ngjyra, nxehtësia, edema, struktura dhe ulçera e këmbës) dhe gjendja e kockave / kyçeve (gishtërinjtë e thua, çekiç gishtërinjtë, hallux valgus, hallux limitus, ekuinusi, amputimi, deformimi i Charcot, rënia e këmbës dhe kufizimi i përbashkët) vlerësohen [38,39]. Individët diabetikë duhet të merren në pyetje gjatë vlerësimeve neurologjike për gjetjet e neuropatisë. Një grup monofilamentesh Semmes-Ëinstein 10-gr, i cili është një metodë e lirë, pa dhimbje dhe e lehtë, përdoret për të vlerësuar humbjen e ndjeshmërisë mbrojtëse në këmbë [16]. Një presion prej 10 g aplikohet në pika të caktuara në zonat e shputës dhe shpinës të këmbës së pacientit. Nëse zbulohet humbje shqisore gjatë vlerësimeve të pacientit duke përdorur këtë filament, këmba është

në rrezik dhe sensi mbrojtës është zhdukur [14]. Diagnoza e këmbës në rrezik konfirmohet me një test dridhje (duke përdorur një pirun për akordim 128 Hz ose një biometrometër), ndjesi pinprick ose reflekset e kyçit të këmbës [26,27]. Pacientët me neuropati, veçanërisht ata me deformime në këmbë ose histori të mëparshme të ulçerës / amputimit, duhet të jenë të kujdesshëm kur zgjedhin këpucë. Një pacient në rrezik duhet të inkurajohet të veshë këpucë terapeutike që ulin presionin e shputës gjatë ecjes për të parandaluar ulçera të përsëritura të shputës së shputës [4, 13]. Të dhënat e marra gjatë ekzaminimit të këmbës përcaktojnë se cilës kategori rreziku i përkasin pacientët për problemet e këmbëve diabetike [14, 19]. Këto kategori janë krijuar për të lehtësuar referimin dhe terapinë pasuese nga një klinikist ose ekip specialiteti dhe për të përcaktuar ndjekjen frekuenca Një kategori me rrezik të lartë shoqërohet me një rrezik të shtuar për ulcera, shtrimin në spital dhe amputimin [14, 22].

1.9.2 Kujdesi infermieror mbi këmbën diabetike

Kujdesi për këmbët është pjesë e jetës së diabetikut ashtu si është pjesë e jetës kontrolli dhe mbajtja e ekuilibruar e diabetit. Infermjeria duhet ta ushtrojë këtë kujdes nëpërmjet kontrollit periodik të këmbëve të diabetikut, duke e instruktuar për kujdesin dhe procedurat e përditshme që duhen ndërmar nga vet i sëmurë.

Si masa preventive:

❖ Depistimi i të sëmurëve me këmbën diabetike

E pyesim për dhëmbje të këmbëve, klaudicacio intermitens, mpirje, shenja të sindromit ishemic në gishta Depistimi për këmbën diabetike bëhet te të gjithë diabetikët çdo vit, kurse kontrollet e çdo diabetiku për gjëndjen e këmbëve çdo 6 muaj si dhe kur kanë ankesa.

❖ Inspektojmë këmbët

Kontrolojmë për plagë, ulçeracione, hyperkeratozë, kallozitetë, deformime, sensibilitetin në shpinën e këmbës, në pulpën e gishtit të madh, në kokat metatarsale, për neuropati, palpojmë pulsën në të dy arteriet dorsalis pedis dhe në arteriet tibiale, shohim venat në kërci, infeksione apo cicatrice, inspektojmë thonjtë, shkëlqimin e tyre, trashjen apo shenja të onykomykozës, shenja të incarnimit të tyre.

❖ Edukojmë pacientin

Edukimi pacientit duke i rritur njohuritë për higjenën e këmbëve, vetkujdesjen për këmbët një edukim të personalizuar sipas dëmtimeve apo rreziqeve që paraqiten te i sëmurë.

Infermjeria kujdeset në mbajtjen e ekuilibruar të diabetit, për ekzaminimet periodike si masa kryesore për parandalimin e komplikacioneve të diabetit.

Infermjeri i familjes apo ai i profilizuar për këmbët diabetike u mësojnë rregullat e vetkontrollit të këmbëve të tyre dhe kujdesin si më poshtë [40].

Kujdesi i vet pacientit:

- Të lajë këmbët çdo ditë me ujë të vakët dhe me sapun të butë.
- Të evitojë banjat e zgjatura dhe ti fshij mirë këmbët e sidomos midis gishtave

- Lëmojmë lehtësisht kallot (trashjet e lëkurës) pas banjës apo dushit. Në se sensibiliteti është i mirë ,përdorim lëmuese të butë dhe të lagur, fërkojmë zonën gjithmonë në të njëjtin drejtim,
- Asnjëherë mos të përdor produkte korozive as të mos tentojnë me mjete prerëse për të hequr kallot. Në se ka probleme me ndjejshmërinë ose qarkullimin të konsultohet me specialistin apo personelin e specializuar për këtë problem (infirmjeren e kujdesit për këmbët ,apo podologun)
- Thonjtë: Të mos mbahen thonjtë tepër të gjatë. Thonjtë duhet të jenë baraz me majën e gjishtave, i lëmoni me një limë thonjsh duke i rumbullakosur ato baraz me majën e gishtit.
- Çorapet: Të mbajnë çorape të pastra dhe ti ndërrojnë çdo ditë. Çorapet te jenë të tilla që ti mbajnë këmbët të thata si leshi apo pambuku .Sintetiket pengojnë thithjen e djersës. Kujdes te llastiku çorapeve se mos shtrëngojnë dhe pengojnë qarkullimin e gjakut, pra të qëndrojnë të lira.
- Këpucët: Të zgjedhi këpucët me kujdes të madh, të jenë të përkulshme, konforte në ecie që mos ta vrasin apo shtrëngojnë.,Të mos shtrëngohen gishtat por të jenë të lirë midis tyre, mos të shtypen apo fërkohen. Të evitojë këpucët më maja. Të blejë këpucë të reja e të përshtatshme kur këmbët janë të ënjtura. Të evitojë takat e larta , (maksimumi 3 cm) sepse ato ushtrojnë shumë presion mbi thëmbër. [40,41].

1.10 Niveli i njohurive e praktikave të infermierëve në raport me menaxhimin e këmbës diabetike

Namëong [6] zbuloi se infermierët dhe trainerët kanë njohuri të pamjaftueshme për kujdesin diabetik të këmbëve, nuk e praktikojnë atë dhe kanë njohuri të pamjaftueshme për t'i ndarë pacientët në grupe sipas niveleve të rrezikut të këmbës .Nisur nga kjo infermieret duhet të kenë njohuri të anatomisë, fizpatologjisë, diagnozës dhe trajtimit te kembes diabetike , pasi zakonisht ato janë të parët në kontakt dhe njohin komplikacionet e kembes diabetike.

Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit të duhur për kujdesin e rregullt të këmbëve luajnë një rol kontribues në shkaktimin e problemeve të këmbëve [28–30]. Një kurs specifik edukimi për kujdesin për këmbët dhe plagët zvogëlon shkallën e ulçerave të këmbëve dhe amputimeve, dhe udhëzimet ekzistuese tregojnë nevojën për edukimin e pacientëve si një parakusht për të parandaluar ulcera [31, 32]. Në fakt, edukimi i pacientëve në vetë-menaxhimin e këmbës konsiderohet gurthemeli për të parandaluar ulcerat diabetike të këmbëve. Qëllimet e trajnimit janë të motivojnë pacientin dhe të krijojnë aftësi adekuate për të maksimizuar përdorimin e metodave parandaluese [13]. Sidoqoftë, infermierët janë pika kryesore e kontaktit për pacientët dhe shihen si një burim informacioni nga pacientët. Në mënyrë që infermierët të përmbushin këtë rol, ata duhet të kenë njohuri në lidhje me menaxhimin e kujdesit diabetik të këmbëve dhe t'ia përcjellin këtë njohuri pacientit [33–35].

Ky kujdes infermior në menaxhimin e këmbës diabetike kërkon të testojë njohuritë e praktikat e infermierëve te spitalit rajonal Vlorë dhe si rrjedhojë të ofrojë informacion për infermierët në mënyrë që ti ndihmojë ata në diagnostikimin dhe trajtimin e pacienteve me kembe diabetike.

Kujdesi infermieror në menaxhimin e këmbës diabetike u siguron infermierëve dhe ofruesve të tjerë të kujdesit shëndetësor një burim gjithëpërfshirës dhe praktik që u lejon atyre të bashkëpunojnë dhe të avokojnë më efektivisht, si dhe të edukojnë pacientet në menaxhimin e këmbës diabetike.

1.11 Studime të realizuara mbi nivelin e njohurive e praktikave të infermierëve në raport me menaxhimin e këmbës diabetike

- ***Studim i kryer në Turqi***

Zahide Kaya dhe Anita Karaca nga universiteti spitalor I Turqisë kanë bërë studimin me temë “*Niveli I njohurive dhe menaxhimit të infermiereve mbi këmbën diabetike*”.

Sipas tyre, infermierët si anëtarë të rëndësishëm të ekipit të trajtimit të diabetit, kanë një rol thelbësor në parandalimin e problemeve të këmbëve diabetike dhe në kujdesin dhe edukimin e pacientëve në rrezik të problemeve të këmbëve diabetike.

Qëllimi I studimit ishte të vlerësoi nivelet e njohurive të infermierëve në lidhje me menaxhimin e kujdesit diabetik në këmbë dhe përcaktoi faktorët ndikues. Ky ishte një studim përshkrues ndër-sektorial. Mostra e hulumtimit përbëhej nga 435 infermierë që punuan në një spital privat. Të dhënat e hulumtimit u mbledhën duke përdorur "Formularin e Informacionit të Infermierit" dhe "Formularin e Nivelit të Njohurive të Infermierëve mbi Menaxhimin e Këmbës Diabetike".

Nga rezultatet u zbulua se 66% e infermierëve nuk morën trajnim në kujdesin diabetik të këmbëve, 80.9% nuk edukuan pacientë me probleme diabetike në këmbë, dhe 77.5% nuk kryen ekzaminime të këmbëve në pacientët diabetikë. Përfundim: Rezultatet e nivelit të njohurive të infermierëve në lidhje me menaxhimin e këmbës diabetike janë adekuate, por kjo njohuri nuk përdoret gjatë kujdesit ndaj pacientit. Në mënyrë që të lehtësohet përfshirja e infermierëve në menaxhimin e këmbëve diabetike, duhet të organizohen programe trajnimi teorike dhe praktike dhe infermierët duhet të inkurajohen të marrin pjesë në këto programe [42].

- ***Studim i kryer në Azi***

Një studim tjetër transversal është kryer nga autorët Sriyani Kumarasinghe Priyadarshika Hettiarachchi, në një nga universitetet e Azisë me temë: “*Njohuritë e infermiereve mbi menaxhimin e këmbës diabetike dhe qëndrimi I tyre ndaj pacientve*”

Autorët pranonin faktin se infermierët luajnë një rol kryesor në kujdesin për plagën, njohuritë dhe qëndrimet e tyre janë të rëndësishme në sigurimin e kujdesit optimal për pacientët

Qëllimi i studimit ishte të vlerësojë njohuritë e infermierëve mbi sëmundjen e ulçerës diabetike dhe qëndrimet e tyre ndaj pacientëve që vuajnë nga ajo dhe të identifikojë faktorët që ndikojnë në to. Kështu studimi u krye në tre spitale mësimore. Të dhënat u mbledhën duke përdorur një pyetësor të paracaktuar, të vërtetuar, të vetë-administruar nga infermierë të rekrutuar me qëllim, pjesëmarrës vullnetarisht (n = 200) të cilët ishin në praktikën e kujdesit për plagët diabetike për ≥ 1 vit.

Rezultatet nxorren se mungesa e trajnimit zyrtar të kujdesit për plagët ishte raportuar nga 91.2%. Rezultati mesatar i njohurive ishte 77.9 (diapazoni 53.3-100 në një shkallë nga 0-100) me 57.8% të infermierëve që merrnin $\geq 80\%$. Infermierët demonstrojnë një qëndrim të përgjithshëm pozitiv ndaj kujdesit për pacientët me ulçerë diabetike (mesatare = 41,

diapazoni 23-50 në një shkallë nga 10-50). Edukimi në shërbim (77.2%) dhe ndarja e njohurive me kolegët (77.9%) ishin burimet më të njohura për azhurnimin e njohurive. Megjithëse 98.6% e infermierëve ishin të interesuar në kujdesin për plagët, vetëm 8.3% dëshironin të merreshin me kërkime. Si përfundim: Mangësitë në njohuritë thelbësore dhe qëndrimet negative mund t'i atribuohen trajnimit joadekuat, azhurnimit nënoptimal të njohurive dhe mungesës së interesit për kërkimin e kujdesit për plagën. Nderkaq studimi tregoi se trajnimi për kujdesin ndaj plagëve duhet të bëhet i detyrueshëm për të përmirësuar cilësinë e kujdesit të dhënë nga infermierët për pacientët me ulçera diabetike. Duhet të inkurajohen zhvillimi i vazhdueshëm profesional, praktikat e bazuara në prova dhe kërkimi i kujdesit për plagët [43].

- ***Studim i kryer ne Pakistan***

Një studim tjetër me temë: “*Njohuritë dhe qëndrimi I infermiereve ndaj menaxhimit te këmbës diabetike*”, është bërë nga Kamran Munaë, Dr. Zeeshan Ahmad³ dhe Aneela Kamran nga Instituti I Shkencave Mjekësore te Pakistanit.

Sipas studimit plaga diabetike në këmbë prek afërsisht 12% të popullsisë totale me diabet mellitus në Pakistan. Infermierët luajnë një rol të rëndësishëm në ekipin e menaxhimit të diabetit. Ky ishte një studim përshkrues kryqëzor i bërë në Institutin Pakistan të Shkencave Mjekësore Islamabad për periudhën tre mujore nga gushti 2018 deri në tetor 2018. Të dhënat u mblodhën nga 125 infermiere përmes një pyetësi të paracaktuar, të strukturuar që përmban pyetje për të hyrë në njohuri, qëndrim dhe praktikë në lidhje me parandalimi, kujdesi dhe menaxhimi i këmbëve diabetike.

Sipas rezultateve vetëm 56% e infermierëve në studim zotëronin njohuri të mira të ulçerave të këmbëve diabetike. Mungesa e trajnimit zyrtar të kujdesit për plagët u raportua nga 67%. Megjithëse 94% e infermierëve ishin të interesuar në kujdesin për plagët, vetëm 5.5% dëshironin të bënin kërkime në këtë temë. Sidoqoftë, kemi vërejtur se ka mungesë të njohurive thelbësore. U vërejt se njohuritë për kujdesin diabetik të këmbëve ishin më të larta në mesin e infermierëve të rinj energjikë, megjithë përvojën më të vogël. Infermierët me përvojë kishin një njohuri të dobët të kujdesit për këmbët diabetike. Si rezultat, cilësia e kujdesit për këmbët diabetike për pacientët do të përmirësohet.

Në përfundim studiuesit pranuan faktin se mangësia në njohuritë thelbësore mund të jetë për shkak të trajnimit joadekuat, azhurnimit joadekuat të njohurive dhe mungesës së interesit për punën kërkimore të kujdesit për plagët. Mungesa e njohurive ndikon keq në sistemin e kujdesit shëndetësor, madje edhe me praninë e qëndrimeve pozitive. Prandaj, një rishikim gjithëpërfshirës i kurseve të infermierisë, trajnimit dhe azhurnimit të njohurive të tyre është i nevojshëm për orë [44].

- ***Studim i kryer ne Malajzi***

Studimi me temë : “*Kujdesi infermior ne menaxhimin e këmbës diabetike*” i kryer ne Institutin e Kerkimeve Shkencore ne Malajzi, vertetonin faktin se infermierët luajnë një rol jetësor në kujdesin dhe parandalimin e ulçerave në pacientët me këmbë diabetike. Qëllimi ishte studimi i nivelit te njohurive dhe qëndrimit të infermierëve ndaj ulçerave të këmbëve diabetike dhe kujdesit të tyre në Spitalin Segamat, Malajzi.

Metodologjia: Një pyetësor i vërtetuar u përdor midis shkurtit 2019 deri në maj 2019 duke mbuluar zona të tilla si demografia, faktorët predispozues të formimit të ulçerës, karakteristikat e ulçerave, ndërlikimet e ulçerave dhe qëndrimi ndaj kujdesit diabetik të këmbëve.

Rezultatet treguan se një total prej 101 infermierësh morën pjesë dhe 57% e pjesëmarrësve vlerësuan dobët në pjesën e njohurive të pyetësorit. Në të gjitha 72% kishin shënuar dobët kur u pyetën në lidhje me ndërlikimet e ulçerave diabetike të këmbëve; 49.5% e infermierëve kishin qëndrim pozitiv ndaj kujdesit diabetik të këmbëve; dhe 79.3% menduan se kujdesi për ulçerën diabetike të këmbës është konsumues i kohës. Shumica e tyre mendojnë se kolegët e tyre janë burimi kryesor i informacionit. Të gjitha variablat demografikë u gjykuan se ishin konfuzë me njohuritë dhe qëndrimin e infermierëve ndaj ulçerave të këmbëve diabetike dhe kujdesit të tyre.

Si perfundim infermierët në këtë qendër kishin njohuri të dobëta ndaj ulçerës diabetike të këmbëve dhe kujdesit të saj. Asnjë nga variablat e studiuar nuk ishin në lidhje me nivelin e njohurive. Njohuritë e mira ose të dobëta të infermierëve nuk korrespondojnë në mënyrë të barabartë me qëndrimin e mirë ose të dobët ndaj kujdesit për ulçerat në këmbë diabetike. Do të nevojitej trajnim më i shpeshtë zyrtar i kujdesit diabetik të këmbëve për të siguruar njohuri më të mira [45].

- ***Studim i kryer ne Nigeri***

Sipas nje studimi te kryer ne Nigeri me teme “*Menaxhimi i kembes diabetike dhe kujdesi infermieror i infermiereve*“ studiuesit pohuan se ulçera diabetike e këmbëve ka çuar në amputime të panumërta dhe ulje të cilësisë së jetës midis individëve që jetojnë me diabet. Kujdesi i specializuar për këmbët diabetike është treguar për të zvogëluar rrezikun e ulçerave të këmbëve dhe amputimit midis diabetikëve. Studimi vlerësoi njohuritë e kujdesit për këmbët diabetike midis 100 infermierëve në Spitalin Mësimor të Universitetit të Port Harcourt dhe Spitalet e Bordit Menaxhues të Spitaleve Shtetërore Rivers (që përfshijnë Spitale të Përgjithshme nga të gjitha zonat e qeverisjes vendore) në Rivers State, Nigeri. Një pyetësor i strukturuar që përmban pyetje mbi aspekte të ndryshme të kujdesit diabetik të këmbëve u administrua nga intervistuesit tek infermierët dhe u vlerësua në përputhje me rethanat.

Rezultatet:treguan se vetëm 34 (34%) kishin trajnim për kujdesin diabetik të këmbëve; dhe shumica e infermierëve që kishin trajnim kishin më shumë se 20 vjet përvojë. Ë është vërejtur se njohuritë e kujdesit për këmbët diabetike ishin dukshëm më të larta në mesin e infermierëve me më shumë se 10 vjet përvojë.Studimi tregon nevojën urgjente për trajnim të organizuar shpesh mbi kujdesin diabetik të këmbëve për praktikuesit e infermierisë për të përmirësuar cilësinë e kujdesit për diabetin në shtetin e Lumenjve, Nigeri [46].

Kapitulli II: Metodologjia

2.1 Qëllimi

Vlerësimi i njohurive dhe praktikave infermierore ne infermierët e spitalit rajonal Vlorë mbi menaxhimin e këmbës diabetike, me qëllim që të evidentohen problemet që hasin infermierët në këtë drejtim.

2.2 Objektivat

- Vlerësimi i njohurive të marra nga praktika e stafit të infermierise të Spitalit Rajonal te Vlorës.
- Vlerësimi i praktikave të marra nga stafi i infermierisë në Spitalin Rajonal të Vlorës.
- Vlerësimi i njohurive të infermiereve mbi faktorët e riskut te këmbës diabetike.
- Vlerësimi i njohurive të infermiereve mbi parandalimin e këmbës diabetike.
- Vlerësimi i edukimit të pacientit mbi menaxhimin e këmbës diabetike.

2.3 Hipoteza

- A ndikojnë faktorët demografikë (arsimi, pavioni, eksperiencia) në nivelin e njohurive e praktikave të menaxhimit të këmbës diabetike?

2.4 Tipi i studimit

Për nga koha e ndodhjes së ngjarjes dhe regjistrimit të informacionit është: **Transversal**, sepse për realizimin e këtij studimi u bë një prerje në kohë.

Prospektiv, ky studim ka një karakteristikë thelbesore, ajo e fillimit me eksozimin ndaj një shkakutari të dyshuar dhe më pas me kalimin e një kohe të caktuar për të përcaktuar shfaqjen ose jo të efektit.

Deskriptiv, sepse na lejon të përshkruajmë në mënyrë observacionale

Kuantitativ, të dhënat e studimit janë sasiore.

2.5 Përshkrimi i zonës së studimit

Ky studim u realizua në qytetin e Vlorës, në shërbimet përkatëse të SRV.

2.6 Popullata dhe Mostra

2.6.1 Karakteristikat e përgjithshme të popullatës

Popullata përfshin personelin infermieror të të dy seksëve, që punon në shërbimet përkatëse të SRV

2.6.2 Kufijtë dhe madhësia e popullatës

Popullata përbëhet nga infermierët profesionistë (janë përjashtuar studentët dhe stazhierët), të cilët në total janë 160 persona.

2.6.3 Madhësia e mostrës

Mostra e marrë prej **100** infermierësh profesionistë të shërbimeve përkatëse të SRV (pavioni i kirurgjise, patologjise, urgjences dhe poliklinika)

2.7 Përshkrimi i instrumentit matës

Pyetësori (instrumenti i përdorur) është i bazuar gati plotësisht mbi literaturën bashkëkohore, që përdoret gjerësisht në insitucionet shëndetësore për të marrë feedback lidhur me njohuritë dhe praktikat infermiore mbi menaxhimin e këmbës diabetike, me qëllim vlerësimin e mangësive, për të motivuar më shumë personelin infermieror në realizimin sa më cilësor të punës në kujdesin infermieror. Pyetësori përmbante pyetje të thjeshta dhe nuk kërkonte informacion që mund ta vinte infermierin në vështirësi gjatë plotësimit të tij, dhe mendojmë se kanë kthyer përgjigje të sinqerta. Infermiereve u janë qartësuar pyetjet individualisht në mënyrë sa më të kuptueshme për ta. Nuk u konstatua ndonjë vështirësi në plotësimin e këtij pyetesori.

Pyetësori përmban:

